

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ 4 D” shpk

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Ne mbeshtetje te ligjit 9901dt 14/04/2008 “ Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare” si dhe te gjithë Legjislacionit Shqiptar ne fuqi

Themeluesi i shoqërisë:

Drini Sitaj, atësia Vendim , shtetas shqiptar , identifikuar me anë të dokumentit te identifikimit me numër 032945328, me numër personal identifikimi I20712082C i datëlindjes 12/07/1982, lindur në Levan, Fier dhe banues në Fier; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Sot, më 20/02/2023, hartoi kete statut te Shoqerise “ 4 D” shpk si me poshte vijon

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Themelohet shoqëria “4 D” Sh.p.k.
- 1.2 Shoqëria është themeluar nga Z. Drini Sitaj i cili është ortak i vetem i shoqërisë.
- 1.3 Shoqëria është Person Juridik Privat dhe nje Shoqeri me Përgjegjesi te Kufizuar.
- 1.4 Shoqëria do te paraqitet me emrin “ 4 D” Sh.p.k. Ky emertim është i vetmi i shoqërisë dhe perdoret ne te gjitha regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe është i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.
- 1.5 Shoqëria vepron sipas Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.
- 1.6 Shoqëria do te kete vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen e percaktuar nga Ortaku i vetem i shoqërisë.
- 1.7 Statuti është ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te plotesohen nga Legjislacioni Shqiptar.

Neni 2:

Objekti

- 2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import, export , Tregti artikuj te ndryshem industriale, materiale ndertimi, pllaka, hidrosanitare, materiale elektrike, pajisje dhe vegla pune, mjete te ndryshme pune, dhenie me qera, marje dhenie me qera skela, sherbim transporti dhe magazinimi per te trete. Si dhe cdo veprimtari tjeter te lidhura me to, qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

Neni 3:

Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.
- 3.2 Ky afat mund te ndryshohet ne çdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.
- 3.3 Shoqëria mund te priset ne çdo moment me vendim te asamblese se ortakeve.

Faqe 1 e 7

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“4 D” shpk*



Neni 4:
Selia

- 4.1 Shoqëria e ka selinë në: FIER; Lagjja Kryengritja e Fierit, Rruga e ish Uzines se Pambukut, Godina Ish Uzina e Pambukut; ZK 8531.
- 4.2 Ndryshimi selise se Shoqerise ne nje adrese te re do te behet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise
- 4.3 Me vendim të Ortakut te vetem, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, te cilat operojne me organe drejtuese dhe me perfaqesues ligjor te emeruar me Vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 1.000.000,00 leke (nje milion) leke.
- 5.2 Pjesemarrja e themeluesit në kapitalin e shoqerise eshte në perputhje me kontributet

Si me poshte:

Ortaku themelues, Drini Sitaj , Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të pergjithshme 1.000.000,00 leke që perben 100 % te kapitalit themeltar të shoqerise;

Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Faqe 2 e 7
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"4 D" shpk



Organi Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - ndryshimet e statutit;

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të rmbrojtur interesat e shoqërisë
- 9.3 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me miratimin e ortakut të vetëm.

Neni 11


Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Faqe 3 e 7

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"4 D" shpk*



Përfashtimi nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- 13.1 Administratori i shoqërisë emërohet **z. Drini Sitaj**, atësia Vendim shtetas shqiptar, identifikuar me anë të dokumentit të identifikimit me numër 032945328, me numër personal identifikimi I20712082C i datëlindjes 12/07/1982, lindur në Levan, Fier dhe banues në Fier, me **afat emërimi 5 vjeçar**, duke filluar nga data e emërimit, me të drejte rizgjedhje
- 13.2 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 13.4 Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve


- 14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:



- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:



- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - jep kredi.
- 15.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 15.8 Padi tësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

- 18.1 Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 18.5 Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Fitimi qe shperndahet

Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Ortakëve te shoqerise sipas raportit te administrimit ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Neni 21

Baza Ligjore

- 20.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

Neni 23

Hyrja ne fuqi


Ky statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaku i vetem i shoqerise.

ORTAKU I VETEM

I

SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "4 D" shpk

Z. Drini SITAJ


(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Faqe 7 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"4 D" shpk